



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:178630

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05842896

PAKR.nr.302/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi - kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.C për shkak të veprës penale blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, si dhe veprën penale mbrojtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe i pandehuri B.M për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 369 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.C, av.Haxhi Millaku, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.316/23 i datës 07.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 19.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit F.C, av.Haxhi Millaku, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.316/23 i datës 07.02.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.316/23 i datës 07.02.2024, të akuzuarit F.C dhe B.M i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar

si në vijim; në pikën I të dispozitivit të akuzuari F.C, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, par. 1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, në pajtim me nenin 44 i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 2,000 (dy mijë) euro, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1,000 € (një mijë) euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë. Ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro.

Në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së të akuzuari i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 3,700 (tre mijë e shtatëqind) euro. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 21.08.2023 deri më datë 15.09.2023 dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 15.09.2023 deri më datë 15.11.2023, i është llogaritur në dënimin unik me gjobë, ashtu që për çdo ditë të kaluar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak do të hiqet 20 € nga dënimi me gjobë dhe pjesa e mbetur e dënimit unik me gjobë në lartësi prej 1,960 € duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse e njëjta nuk ekzekutohet në afatin ligjor, do të zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet një ditë burgim.

Në pikën II të dispozitivit të akuzuarit B.M, për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269, paragrafi 2 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind) euro të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Është urdhëruar konfiskimi i sendeve, dhe atë: a) Substanca narkotike e llojit m....., Tetrahidrokanabinol (THC), pesha neto e përgjithshme, gram sipas ekspertizës AKF-së, 19.09.2023. b) Konfiskohen dy peshore digjitale si dhe shumë ne vlere prej ...,euro. c) Një revole e tipit “.....” me 7 fishekë. d) Urdhërohet Policia e Kosovës që substancën e konfiskuar ta shkatërroj sipas procedurave ligjore në fuqi.

Janë obliguar të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën secili veç e veç nga 100 €, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën secili veç e veç nga 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën e prokurorisë, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarve të i'u shqiptoj dënim me burgim.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.C, av.Haxhi Millaku, për shkak të vendimit mbi dënim dhe shkeljes se ligjit penal, me propozim Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me të butë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.281/2024, datë 24.05.2024, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet s ai përket vendimit mbi dënim dhe të akuzuarve t'iu shqiptohet dënim me burg efektiv, ndërsa ankesa e ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit F.C, av.Haxhi Millaku të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë të akuzuarit F.C dhe mbrojtësi i tij av.Haxhi Millaku, kurse Prokurori i Apelit edhe pse ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë, ndërsa ai akuzuari B.M është larguar nga gjykatorja për shkak të veshjes dhe po ashtu i njëjti nuk ka paraqitur ankesë. Mbrojtësi i të akuzuari F.C, av.Haxhi Millaku pasi elaburoj ankesën theksoj se qëndron pranë pretendimeve ankimore të ushtuara me shkrim dhe ka propozuar qe ankesa e PTH-së të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa i akuzuari e mbështeti mbrojtësin e tij.

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit e të akuzuarit dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Pretendimet e Prokurorisë dhe të mbrojtësit në ankesë

Prokurori në ankesë thekson se dënimi i shqiptuar me dënim me gjobë nga ana e gjykatës, të akuzuarve të lartcekur F.C dhe B.M për veprat penale të lartcekura në rastin konkret konsiderojmë se nuk është adekuat me peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarve të lartcekur. Për këto arsye konsideron se shqiptimi i një dënimi të tillë nuk është adekuat me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, andaj konsiderojmë se me një dënim të tillë të cilin Gjykata ia ka shqiptuar të akuzuarve të lartcekur nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit F.C, av.Haxhi Millaku, thekson se aktgjykimi i atakuar duhet të ndryshohet sa përket vendimit mbi dënimin, ngase nuk paraqet proporcionalitetin e vlerësimit mbi veprën penale që i vihet në barrë të akuzuarit kur dihet fakti se kategoria e tillë e personave çfarë është i mbrojturi ime i cili është në gjendje se rendë shëndetësore dhe i moshuar ..., edhe përkundër kësaj i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe kurrë me parë nuk ka renë në kundërshtim me ligjin, njëherit është në cilësinë e punëtorit (punëtor në punën private) dhe i cili mban familjen me të ardhurat e tija mujore.

Sipas mbrojtës nuk është vërtetuar kontributi i tij në kryerjen e veprës, andaj gjykata është dashur ta ricilësoi veprën penale për shkak të sasisë se vogël, ngase në rastin konkret nuk kemi të bëjë me figurën e veprës penale e cila i vihet në barre sipas aktakuzës, nga shkakut se elementet qenësore të veprës nuk janë formësuar dhe se i njëjti nuk ka kryer veprimet që manifestohet vepra penale, ndërsa gjykata fare nuk është lëshuar në faktin se si erdhi situata tek përskrimi faktik i veprimeve individualisht të përcaktuara nga i akuzuari por në mënyrë të përgjithësuar ka përpiluar dispozitivin e akuzës dhe përskrim e veprimeve. Ashtu që kërkojmë nga gjykata e shkallës se dytë që të vlerësoj dhe ndryshoi edhe cilësimin juridik të veprës penale, pasi që tiparet cilësuese të veprës penale dhe përskrimi faktik i dispozitivit nuk mund të paraqesin këtë vepër penale apo cilësimin juridik të tillë sidomos elementin kualifikues të veprës. Ka shtuar se rrethanat lehtësuese nuk janë vlerësuar sa duhet dhe nuk i është dhënë pesha dhe rëndësia juridikë edhe pse janë prezantuar në aktgjykim por nuk i është dhënë rëndësi rrethanave të tilla, kur dihet fakti se i akuzuari është mbajtës i familjes, dhe i moshës se re, gjendja ekonomike shumë e varfër në bazë të cilëve do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi dënimin e shqiptuar është i padrejtë, kurse dënimi është i rëndë, në kundërshtim me qëllimin e dënimit, nëse e vlerësojmë drejtë dhe në mënyrë të gjithanshme veprën e cila i vihet në barrë të akuzuarit, përgjegjësia e tij penalen rrethanat në të cilat ka ndodhur dhe pasojat kësaj vepre, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket shkelës se ligjit penal dhe vendimit mbi dënim.

Të gjeturat lidhur me shkeljen e ligjit penal

Pretendimet e mbrojtjes se në rastin nga përshkrimi faktik i dispozitivit nuk ekzistojnë elementet e veprës penale nga neni 267 par.1 të KPRK-së, dhe se aktgjykimi duhet të ricilsohet për shkak të sasisë se vogël, ndërsa gjykata nuk është lëshuar në faktin se si erdhi situata tek përshkrimi faktik i veprimeve individualisht të përcaktuara nga i akuzuari por në mënyrë të përgjithësuar ka përpiluar dispozitivin e akuzës dhe përshkrim e veprimeve, janë pretendime të pa bazuar pasi që sipas përshkrimit faktit të dispozitivit të akuzuarit fillimisht u janë gjetur dhe sekuestruar 8 paketime të mbështjella me foli alumini, të mbushura me substancë narkotike e llojit M.... me peshë të përgjithshme prej 12.4 gram, dhe një peshore digjitale, ndërsa gjatë kontrollit në shtëpinë e të pandehurit në pjesën e prapme të shtëpisë është gjetur një qese me substancë narkotike që dyshohet të jetë e llojit M.... me peshë prej 66.2 gram, një peshore digjitale që shërben për matje të narkotikëve, një rrotull me foli që shërben për paketimin e narkotikëve në sasi të vogla, ndërsa në oborr u gjetën dy paketime me substancë narkotike që dyshohet të jetë e llojit M.... me peshë prej 2.3 gram, andaj pretendimet e tilla nuk paraqesin arsye për shkelje të ligjit penal, nga fakti se nga provat të cilat i janë bashkëngjitura aktit akuzues edhe pse të njëjtat nuk janë administruar, për shkak se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, është

vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i njëjti në veprimet e tij ka konsumuar veprën penale nga neni 267 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale edhe është shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv të aktgjykimi të ankimuar, andaj mbi këto arsye nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykitimit, ndërsa në anën tjetër aktgjykimi u vlerësua në drejtim të pretendimeve tjera përkitazi me vendimin mbi dënim.

Të gjatuarat lidhur me vendimin mbi dënim

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e prokurorisë për një dënim me të rendë dh ato të mbrojtësit të akuzuarit për një dënim me të butë nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat konform nenit 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit, kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit ka vlerësuar se të njëjti e kanë pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin e tyre lidhur me veprën penale dhe betimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprat penale, ndërsa rrethana rënduese ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë për faktin se kjo dukuri është në rritje, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë penale, duke i vlerësuar rrethanat e lartcekura të akuzuarve iu ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e prokurorisë se dënimi i shqiptuar nuk është adekuat me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, veç se kanë qenë objekt vlerësimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa disa nga rrethanat e pa përcaktuara në të cilat thirret mbrojtësi i të akuzuarit (i cili herë cek se i akuzuari është i moshuar e herë i moshës së re), nuk justifikojnë një dënim me të butë nga ai të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykitimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo

pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.302/24, datë 19.06.2024

B. Profesionale,

Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

Bashkim Hyseni

Kryetar i kolegjit,

Burim Ademi

Xhevdet Abazi
